



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina

## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së gjashtë të Komitetit për Politikë dhe Financa të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 07.05.2013, e cila filloi në orën 15:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Sami Hamiti, Mustafë Krasniqi, Hazir Borovci, Aziz Pacolli, Engin Beyoglu, Milazim Vitia dhe Shefqet Sylejmani.

**Munguan:** Tefik Mehmeti (me arsye) dhe Shemsi Veseli (me arsye).

Në mbledhje morën pjesë edhe dr. Avdullah Hoti, nënkryetar i Komunës, Bujar Demjaha, përfaqësues i kompanisë projektuese “A desing”, Asdren Osaj, shëf i Zyrës për marrëdhënie me publikun, drejtorët e drejtorive të Komunës, përfaqësuesit e OSBE – së dhe të INPO-së.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Sami Hamiti, kryesues.

Njëzëri u miratua ky

### REND DITE :

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së pestë;
2. Propozimvendimi për miratimin dhe lënien në dispozicion për diskutim publik të Projektplanit zhvillimor komunal për periudhën 2013 – 2022;
3. Propozimvendimi për dhënien e Qendrës Kulturore Rekreative në Gërmi në shfrytëzim të përkohshëm NPL “Sport Marketing” SH A në Prishtinë;
4. Propozimvendimi për lejimin e mjeteve ndërmarrjes publike lokale “Sport Marketing” SH A në Prishtinë;
5. Raporti për arkëtimin, shpenzimet dhe investimet në periudhën 1 janar - 31 mars 2013;
6. Propozimvendimi për shpalljen e z. Lulzim Basha, Kryetar i Bashkësisë së Tiranës, Qytetar nderi i komunës së Prishtinës;
7. Propozimvendimi për garanci të borxhit;
8. Të ndryshme.

## Pika e parë

**Njësori u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së pestë të Komitetit për Politikë dhe Financa.**

## Pika e dytë

**Lidhur me Propozimvendimin për miratimin dhe lënien në dispozicion për diskutim publik të Projektplanit zhvillimor komunal për periudhën 2013 - 2022, të pranishmit i njoftoi Bujar Demjaha, përfaqësues i kompanisë, duke bërë prezantimin e këtij plani në mënyrë elektronike dhe duke elaboruar disa nga komponentet kryesore të tij. Ai ceku se i tërë angazhimi për hartimin e këtij plani ka qenë punë e përbashkët e dy kompanive "A desing" dhe "Politeknika".**

**Aziz Pacolli** tha se kërkesa kryesore ishte që në të ardhmen të trajtohen fshatrat që janë pjesë e Gollakut, të cila kufizohen me Serbinë, pjesë e cila është jashtë çdo plani. Do të ishte mirë që në vitin 2022 të jetë një projekt, të bëhet një prezantim se si do të duket komuna e Prishtinës.

Një dukuri tjetër që vlen të theksohet është edhe mungesa e inxhinierëve të makinerisë në stafin punues të këtij projekti, mungojnë të dhëna lidhur me nxehjen e qytetit, gjegjësisht rreth projektit të kogjenerimit. Të gjitha këto projekte janë paraqitur në pjesën mbitorësore, ndërsa infrastruktura nëntokësore nuk po trajtohet.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga z. Pacolli, **Behxhet Musliu**, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtje së Mjedisit, tha se të gjitha ato elemente që nuk janë trajtuar me këtë plan, do të trajtohen me planin zhvillimor urban.

**Mustafë Krasniqi** përgëzoi për punën e kompanive që kanë bërë hartimin e këtij projektplan.

**Avdullah Hoti** njoftoi se ky projektplan u prezantua në Këshillin e Drejtorëve, ku u dhanë disa vërejtje dhe sugjerime, sidomos u kërkua që të në këtë plan të përfshihen edhe këto projekte: të parashihet një hapësirë për arsimin në përgjithësi, projekti për impiantin e ujërave të zeza, një hapësirë për stadiumin e qytetit, të unifikohet numri i popullsisë së Prishtinës, të gjendet një vend për Spitalin e qytetit, të parashihet një projekt për furnizimin me ujë dhe me ngrohje.

Ai propozoi që për të gjitha këto projekte, të merren të dhënat dhe të përfshihen në këtë projektplan.

**U konstatua se njëzëri u përkrahë Propozimvendimi për miratimin dhe lënien në dispozicion për diskutim publik të Projektplanit zhvillimor komunal për periudhën 2013 - 2022, me plotësim, dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.**

### **Pika e tretë**

**Për Propozimvendimin për dhënien e Qendrës Kulturore Rekreative në Gërmi në shfrytëzim të përkohshëm NPL “Sport Marketing” SH A në Prishtinë, Agim Salihu tha se është propozuar që kjo qendër kulturore t’i jepet për shfrytëzim ndërmarrjes “Sport Marketing”, me qëllim të zhvillimit të aktiviteteve të edukimit, kulturës dhe rekreacionit.**

**U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për dhënien e Qendrës Kulturore Rekreative në Gërmi në shfrytëzim të përkohshëm NPL “Sport Marketing” SH A në Prishtinë dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.**

### **Pika e katërt**

**Lidhur me Propozimvendimin për lejimin e mjeteve ndërmarrjes publike lokale “Sport Marketing” SH A në Prishtinë, Agim Salihu tha se këto mjete janë siguruar nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve, që kanë për qëllim funksionalizimin e Qendrës Kulturore Rekreative në Gërmi.**

**Avdullah Hoti tha se këto mjete i jepen ndërmarrjes për funksionalizimin e kuzhinës. Për të qenë vendim më i kompletuar, duhet të jetë një arsytim se si përdoren këto mjete.**

**U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për lejimin e mjeteve ndërmarrjes publike lokale “Sport Marketing” SH A në Prishtinë dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.**

### **Pika e pestë**

**Lidhur me Raportin për arkëtimin, shpenzimet dhe investimet në periudhën 1 janar - 31 mars 2013, Xhelil Bekteshi, drejtor i Drejtorisë së Financave dhe Pronës, tha se në bazë të Ligjit për menaxhimin e financave, jemi të obliguar që të bëjmë raportin tremujor për të hyrat vetanake dhe shpenzimet buxhetore.**

**U konstatua se njëzëri u përkrah Raporti për arkëtimin, shpenzimet dhe investimet në periudhën 1 janar - 31 mars 2013 dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.**

### **Pika e gjashtë**

**U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për shpalljen e z. Lulëzim Basha, Kryetar i Bashkësisë së Tiranës, Qytetarë nderi i komunës së Prishtinës dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.**

## **Pika e shtatë**

**Lidhur me Propozimvendimin për garanci të borxhit, Agim Salihu** tha se Ndërmarrja Publike Banesore ka kërkuar nga Komuna që të japë garanci për borxhin, me qëllim të financimit, investimeve kapitale, në ndërtimin e objekteve në lagjen “Qyteza Pejton”.

**Aziz Pacolli** propozoi që për këtë propozimvendim të jetë një arsyetim më i gjerë.

**U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për garanci të borxhit dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.**

## **Pika e tetë**

### **Të ndryshme**

**Shefqet Sylejmani** diskutoi lidhur me këto çështje, tri prej të cilave kanë të bëjnë me kërkesa dhe njëra me njoftim:

1. Si kërkesë e parë, kërkoj që të jetësohet linja e transportit të udhëtarëve Bregu i Dielli – Gërmi.
2. Kërkoj që të shqyrtohet kërkesa e kahershme e KF “Hajvalia” për marrjen në menaxhim, të stadiumit të cilin e ka ndërtuar KFOR-i suedez, si dhe kërkoj të dijë se e kujt është prona ku është i ndërtuar stadiumi.
3. Kërkoj që të hyjë në ingjencën të Kuvendit të Komunës së Prishtinës ish-Qendra e Rinisë për arsim, pushim dhe rekreacion “Heronjtë e Kosovës” në Hajvali, dhe njëherësh kërkoj të dijë se në menaxhimin e kujt është kjo qendër.

Si informatë që vlen të paraqitet dhe të diskutohet për të është edhe fakti i veprimeve të njerëzve të pandërgjegjshëm, të cilët po punojnë dhe ndërtojnë pa pasur leje, sidomos gjatë ditëve të festave. Si pasojë e kësaj, me rastin e thyerjes së një pjese të murit për vendosjen e një makine për pastrim kimik, është rrezikuar ndërtesa aty ku banoj. Kërkoj nga drejtoria përgjegjëse e Komunës që të ketë kujdes në dhënien e lejeve për ushtrimin e veprimtarive të ndryshme të biznesit.

**Milazim Vitia** tha se hapësira ku gjendet stadiumi është pjesë e minierës së Hajvalisë.

**Kryesuesi** i njoftoi të pranishmit për një rast sulmi ndaj punëtorit të Inspektionit në detyrë gjatë rrënimit të një ndërtimi pa leje.

Për zgjidhjen e problemit të çështjes së pronësisë së 52 shtëpive në lagjen “Kodra e Diellit”, **Agim Salihu** tha se nuk jemi të kënaqur me përgjigjen, e cila na është kthyer nga niveli qendror. Ne menduam se do të bëhet një zgjidhje që prona t’iu kthehet qytetarëve.

**Kryesuesi** tha se për këtë çështje duhet të bisedohet edhe një herë me nivelin qendror.

**Behxhet Musliu** tha se këtu bëhet fjalë për një eksproprijim të vitit 1985, ku është bërë tjetërsimi i pronës, si pronë shoqërore, për interesin e ndërmarrjes, ndërsa një pjesë ka mbetur pa u realizuar.

*Mbledhja mbaroi në orën 16:45.*

**Procesmbajtësi**  
**Zijadin Gashi**

**KRYESUESI I KOMITETIT**  
**Sami Hamiti, ecc. i dipl.**

Faqe 4 nga 4